



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 478 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 65, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Drivastum-Drishti nga Antikiteti në Mesjetë, Kodra e Muzhilës" 2018**, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita dhe MA. Paulin Pushimaj, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Drivastum-Drishti nga Antikiteti në Mesjetë, Kodra e Muzhilës" 2018**, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita dhe MA. Paulin Pushimaj, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Pastrim nga bimësia i mureve rrethuese dhe rrënojave të ndërtesave në kodrën e Muzhilës, dokumentim fotografik, i cili sëbashku me informacionet e ekspeditave arkeologjike të zhvilluara vitet e kaluara do shërbejnë për zonifikimin e ri.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme, për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO